



Prishtinë, 07.11.2025
Kodi i ZRRE-së: V_2942_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2750_09_25** i datës 23.09.2025;
- Ankesa e konsumatorit e datës 27.10.2025.

në seancën e mbajtur më datë 07.11.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit F.A, nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2750_09_25 i datës 23.09.2025.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 23.09.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2730_05_25 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit F.A, lidhur me kontestimin e faturave të muajit 12/2024, 01/2025 dhe 02/2025.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori F.A brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Nuk është trajtuar çështja e të drejtës së konsumatorit për qasje në njehsor;
- Aplikacioni gjatë muajve dimëror, nuk është i qasshëm, dhe lë hapësirë për manipulime nga KESCO;
- Mospërputhja me orën reale të matësve;
- Faturat e larta të energjisë elektrike, sepse pajisjet janë të njëjta.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 07.11.2025 i ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 27.10.2025; Vendimin e DMK të datës 23.09.2025; Ankesën e konsumatorit në KESCO; Përgjigjën e KESCO-s të datës 20.02.2025; Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 19.03.2025; Fotografitë si në shkresat e lëndës; Transaksionet e konsumatorit, Rrjedhën e Energjisë Elektrike dhe Listat e Leximit. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe analizimit të listave të leximit konstatohet se nga periudha 11/2020 kur edhe është vendosur për matje njehsori elektrik nr. 55691019, ka lexime të rregullta mujore, dhe se leximi i shpenzimeve mujore bëhet përmes AMR-së, pra lexim nga distanca, dhe nuk është evidentuar asnjë parregullsi në këtë pikë matëse. Po ashtu, njehsori elektrik i llojit PLC nënkupton që, ka lexime automatike të konsumit, faturimi është më i saktë, shpenzimet monitorohen në kohë reale dhe ka mundësi për ndaljen dhe rifillimin e furnizimit me energji elektrike nga distanca.

Sa i përket çështjes së ngritur lidhur me faturat e larta të energjisë elektrike, Bordi i ka analizuar edhe shpenzimet e energjisë elektrike së konsumatorit për periudhat e ngjashme, pra në muajt e dimrit, për vitet e kaluara, dhe shpenzimet e konsumatorit janë si vijon: në muajin 12/2023 = **3447.26 kWh**, në muajin 01/2024 = **3385.37 kWh**, në muajin 02/2024 = **2927 kWh**. Po ashtu, shpenzimet e konsumatorit, të një viti paraprak janë si në vijim: muaji 12/2022 = **2502.27 kWh**, në muajin 01/2023 = **2643.33 kWh**, në muajin 02/2023 = **3465.47 kWh**. Ndërkaq, shpenzimet e konsumatorit për muajt të cilët i ka kontestuar, janë si në vijim: muaji 12/2024 = **3118.74 kWh**, në muajin 01/2025 = **3725.22 kWh**, në muajin 02/2025 = **3859.68 kWh**. Pra, nga sa mund të shihet, nuk qëndrojnë pretendimet e konsumatorit për faturim jo të saktë, për shkak se, nga sa mund të shihet, shpenzimet e konsumatorit në periudhën e njëjtë të vitit (në periudhën dimërore) janë relativisht të përafërta dhe kjo nënkupton që konsumatori në vazhdimësi e ka shpenzuar energjinë elektrike për të cilën është faturuar.

Ndërlidhur me çështjen e ngritur lidhur me vendin e vendosjes së njehsorit elektrik, ZRrE iu njofton që, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Kodit të matjes, sistemet matëse janë pronë e OSSh-së, si në vijim: *“Sistemet matëse janë pronë e OSSh-së, sipas ligjit për energjinë. Përgjegjësia e sigurisë së sistemit matës, që instalohet në pronë të konsumatorit duhet të jetë e konsumatorit. Të gjithë njehsorët para se të bëhet instalimi i tyre duhet që të lejohen për përdorim, testohen dhe të vulosen me pllomba shtetërore sipas procedurave të Meteorologjisë nga MTI”*. Po ashtu, edhe sa i përket vendit të instalimit të njehsorit elektrik, përcaktohet që, OSSH do të instalojë njehsorin matës në pronën e konsumatorit dhe jashtë objektit të banimit. Sa i përket vendit që zgjidhet për vendosjen e pajisjeve matëse, për çdo rast, duhet të jetë, i përshtatshëm dhe me qasje të lehtë, të jetë në vend ku nuk ka mbeturina dhe plehra të ndryshme dhe hapësira ku vendoset njehsori, të mos përdoren për qëllime të tjera, dhe duhet të jetë i mbrojtur nga mundësia e hyrjeve të kafshëve që mund të shkaktojnë dëme e të ngjashme. Në këtë kuptim, është në diskrecion të OSSh-që, që të zgjedhë vendin e instalimit të njehsorit.

Sa i përket çështjes së ngritur lidhur me mospërputhjen e orës së njehsorëve elektrik me orën reale, ZRrE iu njofton që, çdo rast i identifikuar i kësaj natyre, me të adresuar në ZRrE, është analizuar dhe është obliguar KESCO-ja që të bëjë korrigjimin e konsumatorëve. Pra, në përgjithësi janë raste shumë të vogla dhe kjo nuk nënkupton që është e shpërndarë tek një numër i madh konsumatorësh.



Përfundimisht, bazuar në shqyrtimin e faturave kontestuese, rrjedhës se energjisë elektrike, listave të leximit konstatohet se KESCO me rastin e faturimit të konsumatorit për shpenzimet e periudhave kontestuese ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji e ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar edhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

Tutje, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, “*të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja*”, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Rregullën për Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, Kodin e Matjes së OSSH-së dhe transaksionet e konsumatorit, Listat e leximit, Rrjedhën e energjisë elektrike, si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit **F.A** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.